



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

SHKUNDJA E MITEVE PËR TRANZICIONIN E FSK-SË NË FORCË MBROJTËSE



Autorët: Dr. Florian Qehaja,

Dr. Ramadan Ilazi

Verzioni original i këtij hulumtimi është i përpiluar në gjuhën angleze. Ky version është përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ndërlidhura mbron të drejtat dhe pronësinë intelektuale. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem mbajtës ose të transmetohet, në çfarëdo forme a me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik a tjetër, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi komercial i të gjitha mediave të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) nuk lejohet pa miratimin me shkrim të QKSS. Ju lutemi kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

SHKUNDJA E MITEVE PËR TRANZICIONIN E FSK-SË NË FORCË MBROJTËSE

PËRMBAJTJA

LIDHUR ME AUTORËT	1
PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	2
HYRJE.....	3
KONTEKSTI DHE TRAJEKTORJA E ZHVILLIMIT TË FSK-SË	4
AKTORË KUNDËRSHTUES DHE ZËRA NGURRUES.....	7
E DREJTA SOVRANE MBIZOTËRUESE	10
PËRFUNDIME	12
BIBLIOGRAFI	13

LIDHUR ME AUTORËT

Dr Florian Qehaja është Kryetar i Bordit të QKSS dhe njëri nga themeluesit e QKSS. Më parë, ai ka shërbyer si Drejtor Ekzekutiv i QKSS (2011-2018) dhe si Shef i Operacioneve (2008-2011). Ai shërben si këshilltar ndërkombëtar për çështjet e sigurisë duke bashkëpunuar me organizatat kryesore qeveritare dhe joqeveritare. Koordinon projektin e ndërtimit të integritetit në sektorin e mbrojtjes në Kosovë, të Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS). Për më tej, ka ofruar shërbime këshillimi dhe konsulence për institucionet dhe proceset e politikëbërjes në Kosovë dhe Shqipëri. Është këshilltar jorezident për CVE i Drejtorit të Programit për Ndërtimin e Paqes dhe të Drejtave të Njeriut në Universitetin Columbia. Floriani është autor i disa botimeve shkencore dhe i politikave në fushën e sigurisë. Floriani së fundmi ka përfunduar anëtarësimin njëvjeçar në Royal College of Defense Studies (RCDS) në Londër. Ishte bashkëpunëtor post-doktoral në Universitetin e Columbia-s (SIPA) si Studiuues i Fulbright. Është doktor i shkencave për studimet e sigurisë nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Lublanës: është diplomuar në Universitetin Sussex (Mbretëria e Bashkuar) në Studimet Bashkëkohore Evropiane (MA) si përfitues i OSI/Chevening, ndërsa diplomën Bachelor e ka në fushën e Drejtësisë nga Universiteti i Prishtinës.

Dr Ramadan (Dani) Ilazi është studiues i lartë në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ku është përfshirë si udhëheqës i ekipit në projektin PAVE nga Programi Kornizë Horizonti 2020 i Bashkimit Evropian. Dani ka doktoraturë në Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti i Qytetit të Dublinit (DCU) në Irlandë dhe gradë Master i Letrave nga Shkolla e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit St. Andrews, si studiues Chevening. Ai ka përfunduar edhe një Seminar për Sigurinë Rajonale me George C. Marshall Center - Qendrën Evropiane për Studime të Sigurisë. Para se të bashkohej me QKSS, Dani ka shërbyer si Zëvendës-Ministër për Integrim Evropian në Qeverinë e Kosovës, ku ishte i angazhuar në mënyrë aktive, ndër të tjera, në zhvillimin e Agjendës Evropiane të Reformës (ERA), dhe dialogun për liberalizimin e vizave. Interesi kërkimor i Danit përfshin ndërhyrje për ndërtimin e paqes pas konfliktit dhe praktikën e përditshme të BE-së për ndërtimin e shtetit, si dhe kapacitetet qeverisëse të institucioneve publike. Ka publikuar lidhur me kapacitetin demokratik dhe qeverisës të institucioneve të Kosovës, përpjekjet për paqe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe për procesin e integritetit Euro-Atlantik.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Kanë kaluar rreth tre vite që kur institucionet e Kosovës bënë hapin përpara me vendimin për të filluar procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) nga një mandat për mbrotje civile e reagim emergjent në forcë mbrojtëse. Sidoqoftë, kjo lëvizje nga udhëheqësia e Kosovës, e nxitur nga mbështetja masive e publikut, u pa me skepticizëm nga disa prej aleatëve tradicionalë të vendit, që kishin frikë se vendimi do të çonte në jostabilitet. Por, a pati vërtetë jostabilitet si rezultat i këtij vendimi? Përgjigjja e shkurtër është - jo.

Duke e parë procesin, është e qartë se pasojat që disa i kishin frikë nga tranzicioni i FSK-së në forcë mbrojtëse për Kosovën ishin të ekzagjeruara - thënë më së buti - dhe duket se vendimi ishte hiç më pak a më shumë se sa një veprim i rregullt teknokratik i institucioneve kosovare. Disa madje mund të pohojnë se në fakt procesi i tranzicionit të mandatit të FSK-së e ka ndihmuar kohezionin shoqëror në Kosovë dhe si i tillë e ka forcuar stabilitetin e vendit. Me fjalë të tjera, diskursi shqetësues për tranzicionin e FSK-së u tregua i papabazuar dhe vendimi deri më sot ka dëshmuar më shumë përfitime se sa që pritej.

GJETJET KRYESORE:

● *Procesi i tranzicionit të mandatit të FSK-së po ecën përpara sipas planit. Ministria e Mbrojtjes (MM) duket se po ndjekë me rigorozitet procesin e tranzicionit siç përcaktohet në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit për ndërtimin e aftësive mbrojtëse. Nuk kishte synim për ambicie të tjera ose "kërcim" nga plani fillestar;*

● *Që nga viti 2018, FSK-ja intensifikoi përpjekjet e veta për të shërbyer si forcë 'me qëllime të mira', si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Në zhvillimin e fundit, ajo dha kontribut të prekshëm gjatë katastrofës së tërmetit në Shqipëri në nëntor 2019 dhe zbarkoi misionin e parë jashtë shtetit në Kuvajt, si pjesë e kontigjentit amerikan IOWA në mars 2021;*

● *Tranzicioni i FSK-së nuk u shëndërrua në ndonjë përshkallëzim marrëdhëniesh ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe trajektorja e zhvillimit të saj deri më tani nuk kontribuoi në narrativën destruktive në marrëdhëniet midis të dy vendeve;*

● *Skeptikët e tranzicionit të FSK-së janë dobësuar, ndërsa ata që mbështesin mandatin e ri janë fuqizuar.*

HYRJE

Tranzicioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në forcë mbrojtëse përfaqëson një rën nga kthesat kryesore për procesin e shtetndërtimit të Kosovës dhe është arritje thelbësore për ambiciet e vendit për t'u bashkuar me aleancën e NATO-s. Për kosovarët, të cilët i mbijetuan një fushate spastrimi etnik gjatë viteve 1990, ekzistenca e një force mbrojtëse ka rëndësi të veçantë emocionale. Rritja dhe zhvillimi i FSK-së ka qenë shpesh rrugë "me gunga", si rezultat i sfidave të brendshme, por edhe i kufizimeve të jashtme që burojnë nga rrugëtimi i vendit drejt pavarësisë.

Transicioni i FSK-së në forcë mbrojtëse ishte i kushtëzuar edhe nga një tranzicion tjetër i cili filloi me fazën ku vendi ndodhet aktualisht: ai i heqjes së mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, që kërkon kapacitete lokale të sigurisë për të marrë një rol të ri dhe për t'i zëvendësuar misionet ndërkombëtare. Prandaj, ishte joreale të pritej se si një shtet i sapokrijuar si Kosova nuk do të kërkonte një proces të modifikimit të mandatit fillestar të FSK-së nga thjesht force e reagimit emergjent në forcë tradicionale të mbrojtjes.

Procesi i rritjes së kapaciteteve të FSK-së që do të shndërrohej në mandat mbrojtës u zhvillua gradualisht dhe me kujdes, me ndihmën e partnerëve dypalësh të Kosovës. Miratimi i pakos ligjore në dhjetor 2018 që i dha FSK-së mandatin e mbrojtjes, një dekadë pasi Kosova deklaroi pavarësinë e saj, shënoi vetëm përfundimin e suksesshëm të një procesi të gjatë. Në përputhje me rrethanat, ky dokument konsideron se tranzicioni i FSK-së në strukturë mbrojtëse përfaqëson një të drejtë të mirëfilltë sovraane të Kosovës dhe është plotësisht në përputhje me angazhimet e vendit për paqe dhe siguri. Me aftësi këmbësorie mbrojtëse të përbërë nga 5,000 trupa aktive - që do të arrihet në periudhën prej 10 vjetësh (deri në vitin 2028) - qëllimi i deklaruar i FSK-së është që të bëhet forcë 'me qëllime të mira' për të gjitha komunitetet në Kosovë. Aftësitë e saj parashikohet të kenë ndikim pozitiv ndërsektorial, veçmas kur FSK-ja merr përsipër përgjegjësinë në zëvendësimin e forcës së udhëhequr nga NATO (KFOR) në vend, atëherë kur rrethanat objektive lejojnë. Sidoqoftë, ky zhvillim varet nga perspektivat reale për integrimin Euro-Atlantik të të gjithë Ballkanit Perëndimor.

Një kritikë tjetër nga skeptikët e tranzicionit të FSK-së përfshinte ndikimin e saj të mundshëm në dialogun e udhëhequr nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Por, realiteti është se tranzicioni i FSK-së kurrsesi nuk e ka penguar procesin e normalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve. Si prishësi kryesor në procesin e shtetndërtimit të Kosovës, Serbia u përpoq pa sukses të instrumentalizojë mandatin dhe profilin e FSK-së në dëm të pozicionimit të Kosovës në shoqërinë ndërkombëtare. Serbia supozon se mandati i mbrojtjes për FSK-në zyrtarisht shënon përfundimin e procesit të shtetndërtimit të Kosovës, të cilin ajo e konteston me ngulm. Për sa kohë nuk mund t'ia sfidojë evoluimin nga pikëpamja ligjore dhe praktike, Serbia tenton të fusë një element pasigurie rreth FSK-së, duke shkaktuar kështu njëfarë niveli të pasigurisë midis fraksioneve të bashkësisë ndërkombëtare. Me ecjen e kohës dhe pas 2.5 vjetësh që nga tranzicioni, FSK-ja as nuk prodhoi dhe as nuk pritet të nxisë ndonjë pasojë negative në lidhje me sigurinë rajonale.

KONTEKSTI DHE TRAJEKTORJA E ZHVILLIMIT TË FSK-SË

Pas një dekade të administratimit ndërkombëtar, Kosova shpalli pavarësinë e saj më 2008 në një koordinim të ngushtë dhe me bekimin e fuqive kryesore perëndimore, si dhe në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të përgatitur nga i Dërguari Special i OKB për procesin e statusit të ardhshëm për Kosovën, Martti Ahtisaari.¹ Grupi Drejtues Ndërkombëtar mbikëqyri pavarësinë e Kosovës deri në vitin 2012.² Sidoqoftë, ky moment historik nuk shënoi fundin dhe as fillimin e përpjekjeve të Kosovës për konsolidimin e plotë të shtetësisë së vet.

Lufta për shtetësi dhe pavarësi nga kosovarët ka qenë e jashtëzakonshme. Që nga vendimi i fuqive të mëdha për tërheqjen e kufijve në Ballkan më 1913 si rezultat i disfatës së Perandorisë Osmane, Kosova u la nën sundimin e Serbisë dhe rrjedhimisht Jugosllavisë. Gjatë regjimeve të ndryshme, popullsia e saj - shumica e të cilëve janë shqiptarë - i është nënshtruar racizmit sistematik, diskriminimit dhe segregimit, pasi mbeti pjesa më e pazhvilluar e ish-Jugosllavisë.³ Procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë arriti kulmin në fillim të viteve 1990 si rezultat i shpërthimit të nacionalizmit të udhëhequr nga udhëheqësi serb Slobodan Millosheviq dhe përpjekjeve të shtuara për dominim nga Serbia përballë njësisë të tjera federale jugosllave.⁴ Shtypja e civilëve në Kosovë arriti kulmin në konfliktin e armatosur midis forcave ushtarake/paramilitare serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).⁵ Fushata e gjerë e spastrimit etnik kundër shqiptarëve të Kosovës dhe frika nga gjenocidi i mundshëm në Kosovë e detyruan NATO-n të ndërhynte ushtarakisht më 1999, pasi qeveria serbe hodhi poshtë Marrëveshjen e Paqes të Rambujesë të negociuar në Francë.⁶ Pas nënshkrimit të marrëveshjes së armëpushimit midis Forcave Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, filloi procesi i tërheqjes së forcave ushtarake, policore dhe paraushtarake jugosllave nga Kosova, si dhe vendosja, nën kujdesin e OKB, e pranive civile dhe ushtarake ndërkombëtare.

Siç është thënë tashmë, administrata ndërkombëtare e Kosovës zgjati deri në vitin 2008, kur vendi shpalli pavarësinë pas një dialogu të shteruar me Serbinë, në kuadër të negociatave të sponsorizuara të OKB për të ardhmen e statusit të Kosovës, të ndërmjetësuar nga Presidenti Martti Ahtisaari. Shteti i Kosovës u njoh nga mbi 100 vende dhe u bë anëtar i dhjetra organizatave ndërkombëtare. Sidoqoftë, mungesa e marrëveshjes me Serbinë po pengon përpjekjet e vendit për t'u bërë anëtar i plotë i bashkësisë ndërkombëtare dhe i Kombeve të Bashkuara (OKB), për shkak të fuqisë së vetos së Rusisë dhe ngurrimit të Kinës. Kosova konsiderohet kandidat i mundshëm për anëtarësim në Bashkimin

1 Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (S/2007/168/Add.1), i disponueshëm në: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20168.pdf>

2 Deklarata e Presidentit për Fundin e Pavarësisë së Mbikëqyrtur të Kosovës, në dispozicion në: <https://obamawhitehouse.archives.gov/the-press-office/2012/09/10/statement-president-end-kosovo-s-supervised-independence>

3 Mark Weller, *Contested Statehood: Kosovo's Struggle for Independence* (Oxford: Oxford University Press, 2009).

4 Shih - the Kosovo Report: Conflict, International Response, Lessons, i disponueshëm në: <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/6D26FF88119644CFC1256989005CD392-thekosovoreport.pdf>

5 Ilazi R. (2020) Peacemaking and Peace Agreements on Kosovo. In: Richmond O., Visoka G. (eds) *The Palgrave Encyclopedia of Peace and Conflict Studies*. Palgrave Macmillan, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-030-11795-5_37-2; Clark., H. (2000). *Civil Resistance in Kosovo*. Pluto Press

6 Alex Bellamy, *Kosovo and International Society* (Palgrave Macmillan, 2002).

Evropian (BE) dhe ka nënshkruar një Marrëveshje Stabilizimi dhe Asociimi (MSA) më 2016;⁷ mban njëfarë bashkëveprimi me NATO-n, megjithëse të kufizuar në çështje teknike.

Përparimi i mëtejshëm i Kosovës për integrimin euro-atlantik po pengohet, ndër të tjera, nga mungesa e njohjes nga pesë vendet anëtare të BE-së.⁸ Ndërsa Kosova ka bërë përparim të dukshëm drejt konsolidimit të brendshëm të shtetësisë së vet, veçmas në lidhje me ushtrimin e kontrollit efektiv të territorit, pavarësisht nga sfidat në pjesën veriore, arritja e një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërish të detyrueshme me Serbinë, siç e kërkon BE, do ta avanconte shumë konsolidimin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar të shtetësisë së Kosovës. Marrëveshja e mundshme pritet ta hapë rrugën për njohjen e Kosovës nga Serbia si dhe integrimin në shoqërinë ndërkombëtare, përfshirë OKB, BE dhe NATO, ndërsa për Serbinë do të shënojë një moment të rëndësishëm për procesin e pranimit në BE si dhe për pajtimin.

Pa dyshim, njëra nga parakushtet kryesore të çdo shteti, pra edhe të Kosovës, është struktura e njëtrajtshme që ndërthur karakteristikat simbolike si edhe ato praktike në drejtim të ushtrimit të funksioneve kryesore të shtetit. Tradicionalisht, forcat e armatosura përfaqësojnë përmasën shtrënguese prandaj "[çdo] shtet... pretendon monopolin e përdorimit të forcës në një territor të caktuar."⁹ Duke pasur parasysh se shtetësia e Kosovës ka kaluar nëpër një trajektore unike dhe mjaft konsultative, hartuesit e propozimit gjithëpërfshirës që çoi në pavarësinë e Kosovës projektuan me kujdes arkitekturën e sektorit të sigurisë, në mënyrë që t'ia përmbushnin kërkesat gjenerike të shtetësisë, ndërsa njëkohësisht e konsideronin dinamikën rajonale në mënyrë që të mos shkaktonin reagim të gjerë, sidomos nga Serbia, e cila vazhdimisht kundërshtonte krijimin e shtetit të Kosovës. Bisedimet e drejtuara nga OKB për të ardhmen e statusit të Kosovës krijuan një propozim me mendimin se përfundimisht do ta bënin më pak të kontestueshëm nga Serbia, ashtu që elementët thelbësorë të çdo shteti - si p.sh. forcat e armatosura - të mund të kornizoheshin "butë", të projektoheshin me fuqi të kufizuar dhe ta shërbenin kryesisht në një mandat civil.

Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës nga i Dërguari i OKB Ahtisaari përfshiu krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) si një formacion i armatosur lehtë deri në 2,500 trupa që do të ndihmonte autoritetet e tjera qendrore për lehtësimin e katastrofave dhe çminimin.¹⁰ Për sa i përket modelit, FSK-ja ishte diçka midis ushtrisë dhe policisë.¹¹ FSK-ja nuk kishte për qëllim të kishte korrelacion institucional me pasardhësin e formacionit gueril të UÇK-së - Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Qëllimi i saj ishte arritja e aftësive të plota operacionale brenda periudhës së parë pesëvjeçare (2008-2013) e më pas mund të bëhej një rishikim ashtu që ta ndryshonte potencialisht mandatin. Kjo periudhë përputhej kryesisht me periudhën e pavarësisë së mbikëqyrrur ndërkombëtare,

7 SAA, *Stabilisation and Association Agreement between EU and Kosovo*, Brussels 2016, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=LEGISSUM:4314927&from=EN>.

8 Deri më sot, Kosova ende nuk është njohur nga: Spanja, Sllovakia, Greqia, Rumania dhe Qiproja (kjo e fundit anëtare vetëm e BE). Arsyet e refuzimit të njohjes janë të ndryshme, nga Spanja që është mosnjohësi më i fortë për shkak të frikës nga pavarësia e Katalonjës, si dhe Qiproja që ka shqetësime të ngjashme mbi Republikën e Qipros Veriore Turke. Tri vendet tjera quhen si "mosnjohës të butë" për shkak të mbajtjes së një marrëdhënieje me Kosovën, por ende nuk e njohin zyrtarisht shtetin, kryesisht për shkak të marrëdhënieve të veçanta me Serbinë.

Për më shumë mbi njohjen e Kosovës shih James Ker Lindsay dhe Ioannis Armatokas, *The Politics of Recognition and Engagement: EU Member State Relations with Kosovo* (Londër: Palgrave Macmillan, 2019)

9 Max Weber, *Essays in Sociology* (Oxford: Oxford University Press, 1958) 95.

10 Kombet e Bashkuara, *Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement*, New York 2007 <https://www.refworld.org/docid/4a54bc360.html>.

11 Florian Qehaja, *International or Local Ownership? Security Sector Development in Post-Independent Kosovo* (Washington DC: Westphallia Press, 2017).

e cila u përmbyll më 2012.¹² Në vitin 2013, Këshilli Atlantik i NATO-s deklaroi se FSK-ja ka arritur kapacitetin e plotë operacional¹³ duke i dhënë prandaj dritë të gjelbër Qeverisë së Kosovës për ta filluar rishikimin që më vonë propozoi shëndërrimin e FSK-së në forcë tradicionale të mbrojtjes.¹⁴ Në dhjetor 2018, pas më se katër vjetësh shqyrtimi strategjik, modifikimi të ligjit dhe koordinimi politik si nga brenda ashtu edhe nga jashtë, Kuvendi i Kosovës miratoi paketën me shumicë dërrmuese e cila i dha mandat mbrojtjeje FSK-së dhe çoi në krijimin e një Ministrie të re të Mbrojtjes.¹⁵

12 The Economist, "Another step" <https://www.economist.com/eastern-approaches/2012/09/13/another-step> (accessed 27 April 2020).

13 NATO, "Kosovo Security Force now self-sustainable" Brussels 2013 https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101890.htm.

14 Qeveria e Kosovës, "Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë" Prishtinë 2014 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analiza_e_Rishikimit_Strategjik_te_Sektorit_te_Sigurise_se_RKS_06032014.pdf.

15 Prishtina Insight, "Assembly ups mandate of Kosovo Security Force" <https://prishtinainsight.com/assembly-ups-mandate-of-kosovo-security-force/>.

AKTORË KUNDËRSHTUES DHE ZËRA NGURRUES

Mandati i FSK-së u hartua me kujdes nga aktorët lokalë në konsultim me partnerët dypalësh të Kosovës, përkatësisht me Shtetet e Bashkuara. Arsyeja e qenësisë së saj ishte që të bëhej forcë 'me qëllime të mira' në ushtrimin e një mandati tradicional të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Fuqia e FSK-së do të ishte 5000 anëtarë aktivë dhe 3000 komponentë rezervë që do të mund të ishin plotësisht operacional në periudhën 10-vjeçare përmes një plani të qartë strategjik të zhvillimit.¹⁶ Projektuesit e bënë të qartë se forca e re do t'i nënshtrohej kontrollit civil dhe demokratik dhe të gjitha investimet do të bazoheshin në aftësitë mbrojtëse të këmbësorisë dhe vetëmbrojtjes territoriale, me qëllim që të ndihmojë autoritetet tjera në Kosovë dhe të marrin pjesë në misionet paqeruajtëse jashtë vendit.¹⁷ Në përgjithësi, mandati i ri i FSK-së nënkupton një forcë legjitime me aftësi të kufizuara, pa kurrfarë projeksioni për ta sfiduar stabilitetin rajonal dhe të bazuar plotësisht në kapacitetet financiare të Kosovës.

Ndonëse arsyetimi mbi mandatin e mbrojtjes së FSK-së nuk mund të sfidohej nga perspektiva e sigurisë dhe nga ajo institucionale, ishte dimensionin makropolitik ai që mbizotëroi dhe pengoi vazhdimisht rrugën drejt përfundimit të një mandati të tillë. Ky ishte rezultat i tri çështjeve të ndërlydhura. Së pari, pasi mandati i ri nënkuptoi një parakusht kyç të shtetësisë, ai u kundërshtua ashpër nga Serbia dhe disa mbështetës të saj, duke aplikuar instrumente politike dhe hibride (p.sh. fushata dezinformimi) për të diskredituar përparimin e saj. Së dyti, Serbia instrumentalizoi serbët e Kosovës, duke përdorur kërcënimin e vetos ndaj çdo vendimi që çon në mandatin e ri të FSK-së, ndërsa pjesëtarët serbë të FSK-së i detyroi të tërhiqen prej saj. Së treti, një pjesë e komunitetit ndërkombëtar shprehu rezerva për ndikimin ndaj normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, duke e konsideruar vendimin si të parakohshëm.

Antagonizmi i prerë i Serbisë ndaj një mandati mbrojtës për FSK-në u manifestua vazhdimisht në diskursin e establishmentit të saj diplomatik dhe politik. Kjo daton që nga koha e konfliktit, kur krijimi i lëvizjes kosovare të rezistencës - e cila kohët e fundit u shëndërrua në formacionin gueril të UÇK-së - shërbeu kundër interesit të saj për të ushtruar kontroll absolut mbi Kosovën. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008, Serbia filloi një ofensivë diplomatike në prishjen e progresit të trajektore së shtetësisë ndërsa përpiqej të portretizonte FSK-në si "forcë me qëllime të këqia" në rajon. Serbia veçoi FSK-në (megjithëse kishte instrumente dhe çështje tjera të ngritura njëkohësisht) për shkak të perceptimit të saj si bërthamë e një force të mbrojtjes të ardhshme që do të kontribuonte në kompletimin - të paktën nga brenda - të arkitekturës së shtetësisë së Kosovës. Megjithëse mandati fillestar i FSK-së ishte i kufizuar në lehtësimin e katastrofave nën mbikëqyrjen e pranisë së NATO-s me një forcë maksimale prej 2,500 trupash (ekuivalent me një gjysmë brigade këmbësorie të armatosur

16 Balkan Insight, "Kosovo votes to turn security force into Army" <https://balkaninsight.com/2018/12/14/kosovo-votes-ksf-formation-into-army-12-14-2018/>.

17 Korrespondenti, 2018.

lehtë), Strategjia e Sigurisë Kombëtare Serbe e shpalli FSK-në kërcënim të drejtpërdrejtë për Serbinë dhe rajonin.¹⁸ Përveç shënjestrimit të transformimit të FSK-së përmes kanaleve politike dhe diplomatike, Serbia futi në “Nishan” FSK-në në kuadër të fushatës së organizuar të dezinformimit, e cila u bë aq e pamëshirshme gjatë periudhës së tranzicionit të saj, deri në pikën që portalet e Beogradit, përfshirë median ruse në Serbi «Sputnik», prodhuan pjesë me motive të luftës¹⁹ duke pretenduar se mandati i ri i FSK-së është shpallja e luftës ndaj Serbisë dhe serbëve të Kosovës. Ishin rreth 30 tema mediatike gjatë periudhës së tranzicionit të FSK-së, të cilat i referoheshin shpërthimit të luftës,²⁰ duke u përpjekur të nxisin tensione artificiale në Kosovë.

Përveç aktiviteteve me përfshirje diplomatike, Strategjia e Serbisë në instrumentalizimin e serbëve të Kosovës për ta sfiduar dhe minuar FSK-në u përqëndrua rreth deputetëve të partisë politike «Lista Serbe», degë e Partisë Progresive Serbe (SNS) të Presidentit Serb Aleksandër Vuçiq, që aktualisht qeverisë në Serbi. Kjo parti mban të gjitha 10 vendet e rezervuara për serbët në Kuvendin e Kosovës: kjo si rezultat i presionit strukturor ndaj serbëve të Kosovës në votimin vetëm për «Listën Serbe» kundër pluralizmit politik midis spektrit politik serb në Kosovë.²¹ “Lista Serbe” përdori kërcënimin e vetos për bllokimin e ndryshimeve kushtetuese që fillimisht kishin për qëllim ngulitjen e ndryshimeve kushtetuese të FSK-së në mënyrë që të ndryshonte edhe emrin në “Forca të Armatosura”. Bazuar në sistemin e Kosovës, çdo ndryshim kushtetues kërkon aprovimin e të ashtuquajturve “shumicë të dy të tretave të dyfishta” (që do të thotë shumicë e kualifikuar e gjithë parlamentit, si dhe shumica e kualifikuar e komuniteteve pakicë, nga të cilat serbët e Kosovës përbëjnë pjesën më të madhe).²² Njëkohësisht, Serbia sistematikisht bëri presion mbi pjesëtarët serbë të FSK-së që të jepnin dorëheqjen masive për t’ia diskredituar përbërjen shumetnike, e cila u ndërtua në dekadën e fundit.²³ Si rezultat, 50% e anëtarëve serbë kolektivisht dhanë dorëheqje më 2018 për shkak të presionit të madh strukturor.²⁴

Aktivitetet destruktive të Serbisë për ta parandaluar tranzicionin e FSK-së ishin të fuqishme, por jo efektive. Për shembull, Beogradi nuk mundi ta përdorte partinë politike “Lista Serbe” për ta bllokuar votimin e legjisllacionit për mandatin e ri të FSK-së, sepse kjo nuk kërkonte ndryshime kushtetuese.²⁵ Sidoqoftë, Serbia ka qenë efektive në lidhje me krijimin e një ambienti të padurueshëm për serbët e Kosovës që ishin pjesë e FSK-së, siç dëshmohet nga dorëheqja kolektive e serbëve nga FSK. Strategjia e Serbisë ishte të rrëronte dhe ta sfidojë karakterin e shpallur multietnik të FSK-së, dhe si të tillë t’ia dobësonte legjitimitetin para bashkësisë ndërkombëtare. Me kalimin e kohës, plotësimi i pozicionit të

18 Qeveria e Serbisë, “National Security Strategy of Serbia” Belgrade, 2009 http://www.mod.gov.rs/multimedia/file/static-ki_sadrzaj/dokumenta/strategije/Strategija%20nacionalne%20bezbednosti%20Republike%20Srbije.pdf.

19 EUvsDisInfo, “700 false news stories in Serbian tabloids in 2018” <https://euvsdisinfo.eu/700-false-news-stories-in-serbian-tabloids-in-2018/>.

20 EUvsDisInfo

21 Balkan Insight, “EU Observers criticise pressure on Kosovo Serb voters” <https://balkaninsight.com/2019/10/08/eu-observers-criticise-pressure-on-kosovo-serb-voters/>.

22 Balkan Insight, “Kosovo May Form Army Bypassing Serb Veto” <https://balkaninsight.com/2017/03/07/kosovo-s-thaçi-by-pass-serb-boycott-to-form-army-03-06-2017/>.

23 Shpat Balaj and Taulant Boshnjaku, “Multiethnicity destruction tendencies - Massive resignations of Serbian members from the Kosovo Security Force and Serbia’s Role” KCSS Prishtina, 2018 <http://www.qkss.org/en/Policy-Papers/Multiethnicity-destruction-tendencies-Massive-resignations-of-Serbian-members-from-the-Kosovo-Security-Force-and-Serbias-Role-1133>.

24 Ibid, 5.

25 Robert Muharremi, “Kosovo Security Force is an Army: Legal Arguments” KCSS Prishtina, 2016 <http://www.qkss.org/en/Policy-Papers/Kosovo-Security-Force-is-an-Army---Legal-Arguments-649>.

lirë për anëtarët e pakicës serbe në njësitë e FSK-së u dëshmuar detyrë e vështirë për shkak të frikësimit të vazhdueshëm të kandidatëve dhe familjeve të tyre, përfshirë kërcënimet dhe dhunën fizike.²⁶

Në anën tjetër, kishte masazhe kundërthënëse që vinin nga bashkësia ndërkombëtare mbi vendimin e tranzicionit të FSK-së. Ndonëse një numër vendesh e konsideronin këtë proces si 'ushtrim normal teknokratik' dhe të drejtë sovrane, janë shprehur rezerva jo nëse por kur duhet të merret vendimi i tillë. Këto shqetësime u shpalsën në kohën e miratimit të pakos ligjore të FSK-së, e cila në Kuvendin e Kosovës arriti në kulmin e marrëdhënieve të tensionuara midis Kosovës dhe Serbisë, nga fundi i vitit 2018. Kjo përkoi sidomos me fushatën e Serbisë për të bllokuar anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL, që çoi nga ana tjetër në vendosjen e tarifës 100% për mallrat serbe nga Kosova.²⁷ Në veçanti, deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s nënkuptonte se vendimi është «në kohë të keqe» për shkak të frikës se mund të shtojë jostabilitet²⁸ megjithëse deklarata nuk mund të interpretohet përfundimisht si deklaratë e Këshillit Atlantik të NATO-s sa kohë që pjesa më e madhe e anëtarëve të NATO-s përshëndetën vendimin ose transmetuan mesazhe të mbështetjes në takimin e Këshillit të Sigurimit të OKB që u zhvillua në dhjetor 2018.²⁹

Megjithë zërat ngurrues në fillim të procesit, NATO vazhdoi mbështetjen për Ministrinë e Mbrojtjes të sapokrijuar me praninë e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s. Ngurrimi midis disa shteteve anëtare gradualisht filloi të zbehej në kohën kur tensionet politike midis Kosovës dhe Serbisë u ulën dhe procesi i gjatë i tranzicionit të FSK-së po kalon nëpër ritmin e planifikuar. Organizatat e tjera ndërkombëtare e konsideruan këtë proces më shumë si 'domen të NATO-s', prandaj u përmbajtën nga komentimi edhe sepse ai kishte konotacion politik përveç kuptimit praktik. Më e rëndësishmja, mesazhet e forta që shpalsin frikën për përkeqësimin e situatës së sigurisë u vërtetuan të pabaza tani afro 3 vite pas tranzicionit të FSK-së në forcë të mbrojtjes.

26 Prishtina Insight, "Threats against KSF Serb members continues" <https://prishtinainsight.com/threats-serb-members-kosovo-security-forces-continue/>.

27 BBC, "Kosovo hits Serbia with 100% tariff amid INTERPOL row" <https://www.bbc.co.uk/news/world-europe-46287975>.

28 NATO, "Statement by NATO General Secretary on the adoption of the laws on the transition of Kosovo Security Force" https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_161631.htm?selectedLocale=en.

29 Balkans Insight, "Thaci and Vucic spar at UN over Kosovo Army" <https://balkaninsight.com/2018/12/18/thaci-vucic-clash-at-un-over-kosovo-army-12-17-2018/>.

E DREJTA SOVRANE MBIZOTËRUESE

Tranzicioni i FSK-së në bërthamë mbrojtëse duhet të shihej që nga fillimi si zhvillim organik në procesin e ndërtimit të shtetit të Kosovës. Konsolidimi i të gjitha instrumenteve të një shteti, përfshirë forcat e armatosura, përfaqëson themelin e mirëfilltë të çdo shteti sa kohë që zhvillimi i tij është në përputhje me aftësitë financiare dhe ato të burimeve njerëzore, si dhe me qëllimin përfundimtar në shërbim të paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare. Vërtet, zhvillimi i FSK-së ka qenë çështje e filtrimit të ndryshëm të pranisë së NATO-s (KFOR) si dhe të partnerëve dypalësh të Kosovës. Kjo nënkuptonte një forcë në përputhje me kërkesat e NATO-s, që mbështet vlerat liberale dhe i shërben interesit afatgjatë për mjedis të sigurt dhe të siguruar. Institucioni ishte në shënjestër të vazhdueshme nga Serbia si një mjet për ta kundërshtuar vetë ekzistencën e shtetit të Kosovës, pavarësisht se tranzicioni i FSK-së nuk shfaq as nuk pret të nxisë ndonjë pasojë praktike në kurriz të serbëve të Kosovës ose të rrezikojë marrëveshjen e normalizimit midis Kosovës dhe Serbisë. Marrëdhëniet e përmirësuara midis Kosovës dhe Serbisë janë proces i qartë politik dhe diplomatik, i cili pritet të përmbillet me lehtësimin e BE-së dhe SHBA-së me qëllim të njohjes reciproke dhe perspektivave të kuptueshme për integrimin euro-atlantik. Kapacitetet ekzistuese dhe të mundshme të FSK-së nuk kanë peshë të proklamuar në mënyrë që eventualisht të kundërpeshojnë marrëdhëniet. Evoluimi i FSK-së në forcë mbrojtëse duhet të shihet në mënyrë rigoroze përmes thjerrëzave të të drejtës sovrane të Kosovës, nevojës institucionale dhe tranzicionit organik në çdo mjedis të administratës ndërkombëtare që kërkon marrjen e plotë të institucioneve lokale si shenjë e pjekurisë vendore. Ekzistojnë katër argumente gjithëpërfshirëse në favor të kësaj, të renditura më poshtë:

Së pari, ekziston një mbështetje e fortë publike ndaj FSK-së si institucion dhe procesi i tranzicionit të saj në forcë mbrojtëse. Politika mbi tranzicionin e FSK-së nënkuptonte - deri tani - një nga proceset më konsultative dhe gjithëpërfshirëse, pa asnjë kundërshtim në asnjë pjesë të shoqërisë. Sipas sondazhit të opinionit publik dhe duke parë trendet në periudhën pesëvjeçare (2013-2018), FSK-ja u konsiderua njëri nga institucionet më të besueshme në Kosovë, duke u vendosur vazhdimisht mbi Policinë dhe KFOR-in.³⁰ Kjo i dha legjitimitet të gjerë procesit të zhvillimit të saj, bazuar në politikën nga poshtë-lart por edhe duke pasur parasysh se çdo strategji e suksesshme duhet të mbështetet realisht në nevojën për sigurimin dhe ruajtjen e mbështetjes publike.³¹ Ndonëse opinionit publik mund të kishte mbështetur përshtypjen e vet në modelin simbolik dhe të përgjithshëm të besimit ndaj forcave të armatosura në mjedise pas konfliktit, ai nënkuptoi një tregues të mjaftueshëm për një proces të drejtuar lokalisht. Kjo shfaqti një nga politikat e rralla të drejtuara nga kërkesa, ndryshe nga një mori rastesh në mjediset paskonfliktuale dhe veçanërisht në modelet 'eksperimentale' të modeleve të Kosovës të drejtuara nga jashtë.³²

E dyta, Mandati i mbrojtjes i FSK-së nuk rezonon me institucione glomaze me implikime financiare e burimore njerëzore për resurset e kufizuara të Kosovës. Ideja për t'i hyrë një mandati tradicional ishte

30 QKSS, "Kosovo Security Barometer" 2012-2018. Për më shumë ju lutem shihni www.qkss.org

31 RCDS, *Getting Strategy Right (Enough)*, (Defence Academy of the United Kingdom: London, 2017) 8

32 Qehaja, 2017.

për të krijuar një aftësi mbrojtëse e cila do të prodhonte dhe eksportonte siguri e prandaj të mos paraqesë asnjë kërcënim, as teorikisht as praktikisht për komunitetet dhe fqinjët e tyre. Vërtet, zërat neoliberalë që bëjnë thirrje për përmbytje nga mbajtja e forcave të armatosura nuk mund ta mbanin si argument konstelacionin rajonal të Ballkanit Perëndimor. Veçmas, armatimi i shtuar i Serbisë dhe blerja e armëve të rënda nga Rusia dhe Kina³³ shkaktoi “dilemën e sigurisë” tradicionale në të cilën armatimi i tepruar i një vendi fqinj përfundimisht përkthehet në pasiguri për vendet e tjera. Me këtë argument, Serbia shpenzon gjithnjë e më shumë në sektorin e mbrojtjes me 1.91% aktuale të PBB-së së saj,³⁴ relativisht më lart se vendet tjera në rajon (shih më poshtë). Këto veprime përforcuan argumentet e Kosovës dhe bënë që i gjithë spektri politik dhe shoqëror të fliste me një zë të vetëm mbi nevojën për të pasur një formë të strukturës së vetëmbrojtjes.

E treta, aftësitë e FSK-së do të ishin në çdo mënyrë relativisht më të ulëta sesa të vendeve fqinje, përkatësisht Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut (të gjitha vende anëtare të NATO-s). Buxheti i FSK-së aktualisht përbën 0.8% -0.9% të PBB-së së Kosovës³⁵ ndryshe nga PBB-ja e Shqipërisë (1.26%), Malit të Zi (1.65%)³⁶ dhe Maqedonisë së Veriut (1.2%). Gjithashtu, sa u përket burimeve njerëzore, forca pritet që deri në vitin 2028 të ketë deri në 5000 trupa aktive që kur shqyrtohen përmes parametrave të territorit dhe numrit të popullsisë është mjaft më e ulët se e Malit të Zi, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Këto shifra sfidojnë çdo pretendim që synon të portretizojë FSK-në si iniciativë të stërmadhe: qëllimet e saj të deklaruar u nënshtrohen vlerave liberale dhe parimeve euro-atlantike, pavarësisht nga vështirësitë ekzistuese për të pasë një shteg të qartë drejt integritimit në NATO për shkak të mosnjohjes nga katër anëtarët e saj.

Së fundi, FSK pritet të marrë gradualisht përgjegjësitë nga misioni paqeruajtës i NATO-s, i cili po zvogëlohet në periudhën e fundit. Ajo tashmë ka bërë një hap para për t’u kthyer në ofrues sigurie nga një konsumator i vetëm sigurie, si rezultat i zbakimit të parë të trupave të saj në mision jashtë shtetit përmes bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Iowa-s.³⁷ Ky argument jo vetëm që bazohet në rritjen e pjekurisë së shtetit, por edhe në vlerësimin e përgjithshëm se prania e përjetshme e misioneve paqeruajtëse ndërkombëtare nuk është një zgjidhje e vlefshme.³⁸ Si pasojë, koha e marrjes së aftësisë së plotë operacionale nga FSK deri në vitin 2028 potencialisht do të përkojë me tërheqjen e trupave të KFOR-it (ose mbetjen eventuale të pranisë simbolike) si dhe marrëveshjen e mundshme ligjore të detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke hapur rrugën për marrëdhëniet e normalizuara. Në këtë mënyrë aftësitë e FSK-së pritet të arrihen me kohë duke mos lënë asnjë boshllëk institucional në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Kështu kjo do të shënonte një arritje edhe për praninë ndërkombëtare që investoi për dekada në Kosovë që të arrihej një qëndrueshmëri institucionale afatgjatë.

33 Reuters, “Serbia faces risk of US sanctions over Russian arms deal” <https://www.reuters.com/article/us-serbia-usa-sanctions/serbia-faces-risk-of-us-sanctions-over-russian-arms-deal-idUSKBN1X1199>.

34 Banka Botërore, “Military expenditures (% e PBB-së)” <https://data.worldbank.org/indicator/MS.MIL.XPND.GD.ZS?view=map>.

35 Ibid.

36 Shqyrtimi i popullsisë botërore, “NATO spending by country” <https://worldpopulationreview.com/countries/nato-spending-by-country/>.

37 RFERL, “Kosovo peacekeepers sent in a first mission abroad” <https://www.rferl.org/a/kosovo-peacekeepers-first-mission-abroad-kuwait/31141764.html>.

38 Timothy Donais, *Peacebuilding and Local Ownership: Post-conflict Consensus Building* (New York: Routledge, 2012).

PËRFUNDIME

Themelet e FSK-së i reflektojnë vlerat demokratike dhe liberale, të përfaquara nga çdo vend synues për integrimin në NATO. Kalimi i saj në forcë mbrojtëse shpallet si i bazuar në qëllime të mira - investimin në një forcë që pritet t'u shërbejë të gjitha komuniteteve në vend dhe të eksportojë siguri përmes kontributit në paqeruajtjen ndërkombëtare. Vendimi për t'i dhënë FSK-së mandat mbrojtës nuk duhet parë ndryshe nga ushtrimi normal teknokratik i çdo vendi që synon krijimin e instrumenteve jetike të shtetit. Ajo qëndron brenda të drejtës sovrane dhe nevojës institucionale ndërsa është e rrënjësor edhe në mbështetjen dërrmuese të publikut, që përfaqësonte njërin nga vendimet e rralla të politikave publike që nënkupton mbështetjen ndërshoqërore. Ajo shënon edhe njërin nga vendimet e jashtëzakonshme në mjedisin post-konfliktual të Kosovës i cili ishte në pronësi vendore dhe në përputhje me kërkesat liberale të ndërtimit të paqes për largimin e pranisë ndërkombëtare kur këto kushte të plotësohen.

Përzgjedhja e Serbisë nga FSK-ja nuk është bazuar në projeksionin e forcës së saj - tani ose në të ardhmen - por në obsesionin e përgjithshëm të Serbisë me evoluimin e institucioneve të Kosovës që përfaqësojnë elementet thelbësore të shtetit. Përpjekjet për paraqitjen e FSK-së si instrument i 'pasigurisë' nuk kanë qenë kurrë të bazuara dhe ishin shumë të ekzagjeruara. Fushata diplomatike e Serbisë për të diskredituar tranzicionin e FSK-së u përdor si mjet negociimi në dialogun dhe negociatat që pasuan. Kjo shkaktoi një fushatë dezinformimi duke shkaktuar ankth artificial në mesin e serbëve të Kosovës dhe provokoi ngurrimin e një pjese të komunitetit ndërkombëtar, i cili e konsideroi ndryshimin e mandatit të FSK-së si "në kohë të keqe" dhe të parakohshëm. Me kalimin e kohës, vendimi u tregua i drejtë, sa kohë që forca parashikohet t'i shërbejë sigurisë si një e mirë publike. Vërtet, me fillimin e paradokohshëm të procesit të tranzicionit nuk mund të parashikohen dobësitë e mundshme institucionale, por ato mund të jenë të pranishme rreth qeverisjes së saj e jo të paraqesin kërcënim për sigurinë rajonale ose marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë.

BIBLIOGRAFI

1. Alex Bellamy, Kosovo and International Society (Palgrave Macmillan, 2002).
2. Balaj Shpat and Taulant Boshnjaku. "Multiethnicity destruction tendencies - Massive resignations of Serbian members from the Kosovo Security Force and Serbia's Role" KCSS Prishtina, 2018 <http://www.qkss.org/en/Policy-Papers/Multiethnicity-destruction-tendencies-Massive-resignations-of-Serbian-members-from-the-Kosovo-Security-Force-and-Serbias-Role-1133>.
3. Balkan Insight, "EU Observers criticise pressure on Kosovo Serb voters" <https://balkaninsight.com/2019/10/08/eu-observers-criticise-pressure-on-kosovo-serb-voters/>.
4. Balkan Insight, "Kosovo May Form Army Bypassing Serb Veto" <https://balkaninsight.com/2017/03/07/kosovo-s-thaci-bypass-serb-boycott-to-form-army-03-06-2017/>.
5. Balkan Insight, "Kosovo votes to turn security force into Army" <https://balkaninsight.com/2018/12/14/kosovo-votes-ksf-transformation-into-army-12-14-2018/>.
6. Balkans Insight, "Thaci and Vucic spar at UN over Kosovo Army" <https://balkaninsight.com/2018/12/18/thaci-vucic-clash-at-un-over-kosovo-army-12-17-2018/>.
7. BBC, "Kosovo hits Serbia with 100% tariff amid INTERPOL row" <https://www.bbc.co.uk/news/world-europe-46287975>.
8. Howard Clark. (2000). Civil Resistance in Kosovo. Pluto Press
9. Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement (S/2007/168/Add.1), available at: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20168.pdf>
10. Donais, Timothy. Peacebuilding and Local Ownership: Post-conflict Consensus Building (New York: Routledge, 2012).
11. EUvsDisInfo, "700 false news stories in Serbian tabloids in 2018" <https://euvsdisinfo.eu/700-false-news-stories-in-serbian-tabloids-in-2018/>.
12. Government of Serbia, "National Security Strategy of Serbia" Belgrade, 2009 http://www.mod.gov.rs/multimedia/file/staticki_sadrzaj_dokumenta/strategije/Strategija%20nacionalne%20bezbednosti%20Republike%20Srbije.pdf.
13. Ilazi R. (2020) Peacemaking and Peace Agreements on Kosovo. In: Richmond O., Visoka G. (eds) The Palgrave Encyclopedia of Peace and Conflict Studies. Palgrave Macmillan, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-030-11795-5_37-2
14. KCSS, "Kosovo Security Barometer" 2012-2018
15. Kosovo Report: Conflict, International Response, Lessons, available at: <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/6D26FF88119644CFC1256989005CD392-thekosovoreport.pdf>
16. Ker Lindsay James and Ioannis Armatolas. The Politics of Recognition and Engagement: EU Member State Relations with Kosovo (London: Palgrave Macmillan, 2019).
17. Korrespondenti, "General Rama explains types of weaponry for Kosovo Army" <https://korrespondenti.com/lajme/gjeneral-rrahman-rama-tregon-se-cfare-do-te-jete-armatimi-i-ushtrise-se-kosoves/>.
18. Kosovo Government, "Strategic Security Sector Review" Prishtina 2014 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analiza_e_Rishikimit_Strategjik_te_Sektorit_te_Sigurise_se_RKS_06032014.pdf.
19. Muharremi, Robert. "Kosovo Security Force is an Army: Legal Arguments" KCSS Prishtina, 2016 <http://www.qkss.org/en/Policy-Papers/Kosovo-Security-Force-is-an-Army---Legal-Arguments--649>.
20. NATO, "Kosovo Security Force now self-sustainable" Brussels 2013 https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101890.htm.
21. NATO, "Statement by NATO General Secretary on the adoption of the laws on the transition of Kosovo Security Force" https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_161631.htm?selectedLocale=en.

22. Prishtina Insight, "Assembly ups mandate of Kosovo Security Force" <https://prishtinainsight.com/assembly-ups-mandate-of-kosovo-security-force/>.
23. Prishtina Insight, "Threats against KSF Serb members continues" <https://prishtinainsight.com/threats-serb-members-kosovo-security-forces-continue/>.
24. Qehaja, Florian. International or Local Ownership? Security Sector Development in Post-Independent Kosovo (Washington DC: Westphallia Press, 2017).
25. Radio Free Europe, "Kosovo slaps 100 percent tariffs on Serbia and Bosnia to defend its vital interest" <https://www.rferl.org/a/kosovo-slaps-100-percent-tariffs-on-serbia-bosnia-to-defend-vital-interest-/29613285.html>.
26. Radio Free Europe, "Kosovo peacekeepers sent in a first mission abroad" <https://www.rferl.org/a/kosovo-peacekeepers-first-mission-abroad-kuwait/31141764.html>.
27. RCDS, Getting Strategy Right (Enough), (Defence Academy of the United Kingdom: London, 2017)
28. Reuters, "Serbia faces risk of US sanctions over Russian arms deal" <https://www.reuters.com/article/us-serbia-usa-sanctions/serbia-faces-risk-of-us-sanctions-over-russian-arms-deal-idUSKBN1X1199>.
29. SAA, Stabilisation and Association Agreement between EU and Kosovo, Brussels 2016, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=LEGISSUM:4314927&from=EN>.
30. Statement by the President on the End of Kosovo's Supervised Independence, (White House) available at: <https://obamawhitehouse.archives.gov/the-press-office/2012/09/10/statement-president-end-kosovo-s-supervised-independence>
31. The Economist, "Another step" <https://www.economist.com/eastern-approaches/2012/09/13/another-step>.
32. The World Bank, "Military expenditures (% of GDP)" <https://data.worldbank.org/indicator/MS.MIL.XPND.GD.ZS?view=map>.
33. United Nations, Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement, New York 2007 <https://www.refworld.org/docid/4a54bc360.html>.
34. Weber, Max. Essays in Sociology (Oxford: Oxford University Press, 1958).
35. Weller, Mark. Contested Statehood: Kosovo's Struggle for Independence (Oxford: Oxford University Press, 2009).
36. World Population Review, "NATO spending by country" <https://worldpopulationreview.com/countries/nato-spending-by-country/>.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës“Pjetër Bogdani”

327(496.51:497.11)

355(496.51)

Qehaja, Florian

Shkundja e miteve për tranzicionin e FSK-së në forcë mbrojtëse / Florian Qehaja, Ramadan Ilazi. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2021. - 20 f. ; 23 cm.

Kosova -- Forcat e armatosura

ISBN 978-9951-799-36-2

Aleph [000097863]

ISBN 978-9951-799-36-2



9 789951 799362